



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 566 Prot

Tiranë, më 31/01 /2020

URDHËR

Nr. 53, Datë 31/01 /2020

**PËR NGRITJEN E KOMITETIT TË PËRKOHSHËM PËR INFEKSIONIN E PËRHAPUR  
NGA CORONAVIRUS I RI**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 33 gërma “ë” të ligjit nr.15 datë 10.03.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirus i ri pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Komiteti i përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirus i ri ka këtë përbërje:

a. Znj.Mira Rakacolli	Zv. Ministre, MSHMS	Kryetare
b. Znj.Flutra Beqo	Drejtor MSHMS	anëtar
c. Znj.Albana Fico	Drejtor ISHP	anëtar
d. Znj.Silva Bino	Drejtor departamenti ISHP	anëtar
e. Znj.Vjollca Braho	K/inspektor ISHSH	anëtar
f. Znj. Najada Como	Përgjegjës shërbimi QSUT	anëtar
g. Z.Tritan Kalo	Mjek infeksionist QSUT	anëtar
h. Z.Skënder Brataj	Drejtor QKUM	anëtar
i. Znj.Mirela Cami	Drejtor OSHKSH	anëtar
j. Z.Andi Koraqi	Përgjegjës shërbimi QSUT	anëtar
k. Znj. Gjeorgjina Lito	Pediatër Infeksionist QSUT	anëtar
l. Znj. Narvina Sinani	Drejtor AKBPM	anëtar
3. Sekretar i Komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirus i ri është Znj.Eugena Tomini, Shefe e shërbimit të inteligjencës epidemike pranë ISHP-së.
4. Komiteti i përkohshëm për infeksionin e përhapur nga coronavirus i ri ka për detyrë:
  - a. Të përgatisë dokumentacionin dhe të monitorojë procesin e verifikimit për rastet e mundshme të përhapjes së infeksionit të coronavirus i ri.

- b. Të rishikojë dhe monitorojë aktivitetet verifikuese në nivel kombëtar bazuar në procedurat standarte operacionale dhe rekomandimet e OBSH-së.
- c. Të përgatishë raportet kombëtare për Zyrën Rajonale të OBSH-së.
- d. Të nxisë strukturat shëndetësore, Institutin e Shëndetit Publik, si dhe struktura të tjera lokale dhe qendrore për zbatimin e planeve dhe urdhëresave, për të monitoruar progresin kundrejt qëllimeve të eliminimit të përhapjes së infeksionit të coronavirus i ri.
- e. Të përgatishë planet e veprimit për dokumentimin dhe verifikimin duke përcaktuar përgjegjësitë, produktet, burimet, dhe afatet kohore të aktiviteteve në bashkëpunim me departamentin e epidemiologjise dhe kontrollin e sëmundjeve infektive në ISHP.
- f. Të raportojë tek Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjithë çështjet, dokumentat dhe vendimet e marra në mbledhjet e Komitetit.
- g. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik, për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

